

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ku dallon Hashim Thaçi nga Oso Kuka dhe Ded Gjo Luli?
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/ku-dallon-hashim-thaci-nga-oso-kuka-dhe-ded-gjo-luli-i586751
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	unreachable

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 18:23:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 18:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d4ebf497720683f36dbd626e4be640e1e56b49bcb2e0d89bda3f177b54170d84
TEKSTI	253cb4d418fa0354afae0c2e7b2d16e7a5dc89ad77e75c5eb67475b9e2efec87
PAMJA	11defbcb4aa57b4497f882cebe234be93da1e90d6352f0cb5e85f0e0e517a648

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ed03653a80136243e7a21d19b66ef20910f118044e2fb9a2c9ea8915f2aea7a9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	902d0413a229cd6f0d4d0cd18f47f680be9b1c51dede64b7e44b0e89ca82109d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ed03653a80136243e7a21d19b66ef20910f118044e2fb9a2c9ea8915f2aea7a9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1 e [Shqipëria bien, por s'het pak/ Importet rriten në 75.6 miliarde leke, deficit tregtar thellohet me 17.4% ish-diplomati amerikan pas denimit të krereve të UÇK-se: U befasona fundit](#)

Ku dallon Hashim Thaçi nga Oso Kuka dhe Ded Gjo Luli?



17 Shtator 2026, 20:25Blog Fatbardh Amursi

Nuk është rastësi, që, fill pas vendimit të Gjykatës Speciale të Hagës, u cituan vargje nga “Lahuta e malcis” së Fishtës, sidomos vargjet: “Uh! Europë, ti kurva e motit./Qi i rae mohit besës e Zotit./Po a ky â shëji i gjytetnis:/Me dâ tokën e Shqypnis/Për me mbajtë klysh e Rusis?” Tani s’është problem copëtimi, shitje kufijsh, por përçarja, që kinse patriotët po tentojnë të bëjnë me rapsodira e qeleshe. Fishta të gjithë fajin ia vë Evropës, ndërsa Kimete Berisha drejton gishtin edhe tek të vetët: “Serbia bëri aktakuzën, por shqiptarët iu bënë dëshmitarë... Ka diçka më të frikshme se urrejtja e armikut: gëzimi i përbashkët me të. Armiku feston. Ti i bashkohesh. Dhe fitoren e tij e quan tënden.” Lahuta e Fishtës bie era barut dhe gjëkundi s’ndihet era e shampanjës.

Nëse i rikthehesh Lahutës së Malcis, Fishta të duket më i qartë nga të gjithë politikanët e sotëm, nga analistë e portalistë po e po, përfshi dhe ca trapa që na hiqen për orakuj. Këta të fundit shfaqen si me telekomandë. Fishta e ka të qartë pse Hashim Thaçi u burgos, sikurse e kishte pse Oso Kuka hodhi veten në erë për t’mos iu dorëzuar malazesëve apo pse Ded Gjo Luli u vra në pritë nga serbo-malasezët? Të tre janë viktimë të së njëjtës dorë, sikurse ishte dhe vetë Fishta i ndaluar këndej dhe matanë kufirit. Fishta nuk ishte shoven, sikurse e etiketuan, as sllavofob, sikurse dhe Hashim Thaçi. Shoveni të rrëmben toka, është agresiv. Shkjau iu vardis shqiptarit dhe s’po e lë me ngre kryet, ankohet Fishta: “Gjithmonë sherr, gjithmnë bela.”

Nëse ai mallkon, sikurse është ky varg: “Moskovit që iu thaftë hovi”, na ka nda në Kongres së Berlinit, e “ka pleqnue që Shqipëria do dahet” dhe a do i dalë Rozafës për zot shkodrani Oso Kuka, sikurse i doli Hashin Thaçi? Por, aty ku s’bën punë trimëria e Milosheviçit: hyn dredhija e Vuçiçit, “Me qit fitme ndër shqiptarë”, sikurse shkruan Fishta, duke përmendur dhe korruptimin me para. Në librin e tij me kujtime, Eqerem bej Vlora, thotë se Esaat Pashë Toptani e dorëzoi Shkodrën kundrejt një shume parash. Dhe e treta që sllavët përdorin kundër shqiptarëve është dasia, shkruan Fishta tek “Lahuta e malcis”, veri-jug dje apo shqiptar-kosovar, sikurse sot.

Sipas Fishtës, edhe “Koha e s’bardhës ka perëndue”, se në vend të shpatës ka hy pushka, në vend të perëndisë-ari dhe në vend të drejtësisë-leverdija, ku Evropa vetë jep shembullin e para, ndërsa zanat e malit i luten perëndisë që me eshtrat e fatosëve të dikurshme të ngjallen kreshnikët e rinj. Ndaj Mujin dhe Halilin Fishta i zëvendësoi me Oso Kukën (Kuvendi i Berlinit) dhe Dedë Gjon Lulin (Kuvendu i Londrës) deri sa të mbërrijmë tek Hashim Thaçi (Gjykata Speciale e Hagës), ndërkohë që lahuta ia ka lënë vendin çiftelisë. Oso Kuka hodhi veten në erë, ndaj i thonë dhe Oso baruti, Ded Gjo Luli u vra në pritë nga serbë e malazesë, Hashim Thaçi dënohet me 25 vite. E njëjta skemë eliminimi. Nëse Oso Kuka dhe Ded Gjo Luli humbën trojet dhe jetën, Hashim Thaçi fitoi Kosovën dhe humbjen e lirisë me 25 vite burg, nëse ky dënim qendron në fuqi. Ky është dallimi, që Fishta e besonte se do të vinte: “Prapë zojë më vedi duel Shqypnia”,/“Për inat të shkjeve të Ballkanit, për gazep të atij Sulltani.” Me krijimin e shteti të Kosovës kjo ky inat u dyfishua.

Tek Lahuta e Fishtës nuk mund të mos bëj përshtypje ky fakt: Abdyl Frashëri, kryetar i delegacionit të Lidhjes së Prizrenit, u përpoq ta bindte kryetarin e Kongresit të Berlinit, kancelarin Bismark, në një takim që pati me të, që ta përfshinte në rendin e ditës së një seance edhe çështjen e kombit shqiptar. Kancelari jo vetëm e refuzoi, por na hoqi vizën si komb, ndërkohë që knjaz Nikolla edhe pse i veshun si lyps pranohet në kuvend. Ankesat e tij të përvojshme prekin zemrat e koncelarëve dhe “cubi na doli zotni?!-shkruan Fishta. Krajl Nikolla pi verë, ha gështenja të pjekuna dhe bisedon me të shoqen, të cilën e sheh me petka mbretërore. “Ma dollamë nuk ke me veshë/por krejt në arë ke me shëndrit.../Ajo rri pa za/Me gjypër çorapë me ba.”

Kimete Berisha me gojën plotë shprehet: “Mua më shpëtoi UÇK-ja” shoqëruar me indinjatën ndaj vendimit të Gjykatës Speciale të Hagës: “Kuvendi i Kosovës, i bindur se UÇK-ja ishte e pastër, i themeloi Dhomat Speciale. Nuk e dinte, s’kishte si ta dinte, se Gjykata Speciale mund të shndërrohej në një shëriat të frikshëm në mes të Evropës...Vendimi për dënimin e tyre, i mbështetur në “besim”, “përshtypje” e “gojëdhëna”, është shëriat. E kjo që ka ndodhur në Hagë është shëriat evropian.” Se kush fut fitila mes shqiptarëve dihet, që mernte para dhe kjo s’është më e fshehtë, por që Evropa të shkeltë mbi besimin e shqiptarëve s’është hera e parë. Dredhitë e saj i ka denoncuar Fishta tek Lahuta e Malcis. Ajo që të bën përshtypje, të gjithë ata që e përdorin Fishtën kundër regjimit diktatorial, duke i qarë hallin për censurimin e veprës së tij, thartohen nga fryma e Lahutës së Malcis, nga zemërimi i tij ndaj të shiturve, dredharakëve dhe ata që fusin grndje mes shqiptarëve. Lahuta e Malcisë fillon me betejën për mbrojtjen e Vrinës, ishull në liqenin e Shkodrës, nga Oso Kuka që tani i përketë Malit të Zi. Përsëri del një ishull dhe ky është Sazani. Mos dhe ky po i trazon ujërat?

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Miku i Serbisë, "lot" për UÇK

18:00 Blog

[Në emër të popullit të Kosovës](#)


15:20 Blog / 13 komente

[10 arsye përse Kosova arriti këtu](#)

12:50 Blog / 28 komente

[Vendimi i Hagës si fatkeqësia e një populli që lirinë ia kthejnë në krim](#)

09:50 Blog / 6 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.